

Bartësi Privat i Arsimit të Lartë  
Private Bearer of Higher Education



# ALMA MATER EUROPAEA CAMPUS COLLEGE REZONANCA



Tel: +381 38 544-754

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

Nr.Prot. :	
Datë :	

## **STATUTI I INSTITUTIT PËR KËRKIME DHE SHKENCË**

**PRISHTINË  
2021**

Mbështetur në nenin 11 të LIGJI Nr. 04/L-135 PËR VEPRIMTARI KËRKIMORE-SHKENCORE, nenit 38, pika 5.2 i Statutit të Alma Mater Europaea Campus College Rezonanca (AMECCR), në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, Senati i AMECCR, në mbledhjen e datës 10.12.2021, miratoi këtë :

## STATUTI I INSTITUTIT PËR KËRKIME DHE SHKENCË

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Qëllimi

##### Neni 1

Më këtë Statut përcaktohet rëndësia, pozita, organizimi i Institutit për Kërkime dhe Shkencë (në tekstin e mëtejme: Instituti), detyrat dhe kushtet që duhet plotësuar për krijimin e marrëdhënies së punës në Institut për veprimtari kërkimore-shkencore.

##### Neni 2

Veprimtaria kërkimore-shkencore e Institutit është me rëndësi dhe interes të veçantë për Kolegjin. Instituti kryen punën kërkimore-shkencore-hulumtuese nga fushat e caktuara shkencore. Instituti realizon edhe projekte shkencore hulumtuese të përbashkëta.

#### Ushtrimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe themelimi i IKSH

##### Neni 3

Instituti është institucion i brendshëm i Alma Mater Europaea Campus College Rezonanca, me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtari kërkimore-shkencore dhe me Statutin e Institutit.

##### Neni 4

Instituti kryen këto veprimtari:

- kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për ngritjen e brezit të ri kërkimor-shkencor; përfshirjen e studentëve dhe të studentëve të studimeve pasuniversitare në punën kërkimore-shkencore që realizohet në Kolegj;
- nxit veprimtarinë kërkimore-shkencore me qëllim të integritit në hapësirën shkencore ndërkombëtare, rrënjosjen e parimeve të metodës shkencore dhe zhvillimin e njohurive të reja ndër brezat e rinjë të shoqërisë në përgjithësi;
- zhvillon aktivitetet për intensifikimin e bashkëpunimit në sferën e veprimtarisë kërkimore-shkencore me institucionet tjera vendore dhe të jashtë, në kuptim të zhvillimit të programeve hulumtuese të përbashkëta, kryerjen e studimeve dhe kërkimeve me karakter teorik e praktik nga fusha të ndryshme me interes të veçantë;
- motivon dhe përkrahë tërë stafin e vet akademik për punë krijuese sistematike, me qëllim të kërkimit dhe zhvillimit të njohurive të reja, si dhe shfrytëzimit dhe zbatimit të këtyre rezultateve në praktikë;

- planifikon infrastrukturën e domosdoshme për veprimtari të mirëfilltë kërkimore-shkencore dhe ndërmeret aktivitetet për zhvillimin e laboratorëve hulumtues;
- kujdeset për paisjen dhe funksionimin e mirëfilltë të bibliotekës shkencore;
- funksionalizimin e shërbimit informativ shkencor;
- mbështetë veprimtarinë botuese shkencore;
- merret me përcjelljen e aktivitetit mentorues të stafit akademik për punimet e diplomës master dhe disertacionet e doktoratës;
- merret me vlerësimin e propozim-projekteve kërkimore-shkencore sipas kritereve të përgjithshme për praninë të projektit;
- harton planin e aktiviteteve kërkimore-shkencore për çdo vit kalendarik dhe analizon realizimin e tyre;
- vlerëson kompetencat profesionalo-shkencore të realizuesve të projekteve dhe të punëtorëve të tjerë shkencorë të përfshirë në projekte;
- vlerëson përmbushjen dhe respektimin e normave etike të projekteve shkencore të propozuara;
- inicon procedurat e aprovimit të hulumtimeve nga Odat e profesionistëve shëndetësore, për lëmentë e shkencave mjekësore;
- merret me aktivitetet për realizimin e takimeve profesionale, simpoziumeve, konferencave, kongreseve, etj., si organizime vetanake;
- organizon punën e vazhdueshme të Shërbimit Informativ Shkencor (SHISH). SHISH, në mënyrë sistematike, gjatë tërë viti kalendarik, bën njoftimin e stafit akademik me agjendën e takimeve, konferencave dhe kongreseve, nacionale dhe internacionale të lëmenjëve përkatës, në mënyrë që të përparojë veprimtarinë në fushën e publikimeve si dhe të informimit adekuat kërkimor-shkencor.

#### Neni 5

Instituti bashkëpunon ngushtë me njësitë organizative në kuadër të Kolegjit, vihet në shërbim të avancimit të veprimtarisë hulumtuese në institucione, kurse për punën e vet i përgjigjet Rektorit të Kolegjit.

#### Organizimi dhe qeverisja

#### Neni 6

Organizimi i brendshëm i Institutit përcaktohet me këtë Statut.

#### Neni 7

Organet e Institutit janë: Këshilli Drejtues, Drejtori i Institutit dhe Këshilli Shkencor.

#### Këshilli drejtues

#### Neni 8

Këshilli drejtues është organ kolegjal i qeverisjes së Institutit.

Këshillin e përbëjnë: Prorektori për shkencë, Drejtori i Institutit, prodekanët për shkencë të tre njësive akademike.

Këshillin drejtues e udhëheqë Prorektori për shkencë.

## Këshilli shkencor

### Neni 9

Këshilli shkencor është organ profesional i Institutit që:

- (a) shqyrton dhe vendosë për çështjet shkencore dhe profesionale
- (b) harton planin vjetor të punës së Institutit
- (c) ndihmon hartimin e planit vjetor financiar
- (d) miratojnë propozim-projektet hulumtuese të propozuara nga Këshillat e fushave shkencore
- (e) përgatitë raportet e progresit në implementim të projekteve shkencore
- (f) lejon organizimin e takimeve shkencore
- (g) propozon alokimin e mjeteve për veprimtarinë kërkimore-shkencore
- (h) si dhe kryen edhe punë të tjera në pajtim me këtë Statut.

Këshilli shkencor përbëhet nga prodekanët për shkencë të tre njësive akademike, udhëheqësit e këshillave të fushave të veçanta shkencore (7 anëtarë), këshilltarët shkencorë (5 anëtarë).

Anëtarë të Këshillit shkencor mund të zgjidhen edhe punëtorë shkencorë të cilët nuk janë të punësuar në Institut, por janë të angazhuar në realizimin e projekteve shkencore.

Me Këshillin shkencor kryeson prorektori për shkencë.

## Drejtori i Institutit

### Neni 10

Drejtori i Institutit është organ punëdrejtues i pavarur në kryerjen e detyrave të veta në kuadër të kompetencave të përcaktuara me dispozitat e Statutit të Kolegjit dhe të Statutit të Institutit. Për punën e tij i përgjigjet Këshillit drejtues, kurse për ligjshmërinë e punës së Institutit i përgjigjet organeve kompetente të Kolegjit.

Drejtori i Instituti emërohet nga Senati, me propozim të Rektorit të Kolegjit.

### Neni 11

Drejtori i Institutit koordinon punët rreth kryerjes së veprimtarisë së Institutit dhe udhëheq punët e tilla, kujdeset për zbatimin e vendimeve të organeve qeverisëse dhe shkencore të Institutit, përfaqëson Institutin dhe kujdeset për ligjshmërinë në punët e Institutit dhe të organeve të tij.

Në kryerjen e këtyre funksioneve Drejtori i Institutit merret posaçërisht me këto punë:

- Udhëheq dhe organizon punën kërkimore-shkencore të Institutit.
- Harton projektin e planit dhe të programit për punën kërkimore-shkencore të Seksionit.
- Angazhon punëtorët në realizimin e Plan - Programit vjetor dhe afatgjatë dhe përgjigjet për realizimin me kohë të detyrave të parapara me plan dhe program.
- Orienton dhe koordinon punën e grupeve kërkimor-shkencore si dhe të individëve, qofshin këta punëtorë të Institutit apo bashkëpunëtorë të jashtëm të inkuadruar në realizimin e planit të Institutit.
- Shpjegon dhe arsyeton propozimet për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe kujdeset për ngritjen profesionale lidhur me projekte dhe punime të ndryshme.

- Merr pjesë në realizimin e detyrave kërkimore-shkencore të Institutit, është përgjegjës për bashkëpunim me institucione dhe individë të jashtëm në kuadër të punës së Institutit .
- Organizon punën shkencore dhe profesionale në kuadër të veprimtarisë dhe të aktiviteteve të përcaktuara me program dhe plane të punës,
- Kujdeset për përparimin e metodave në punë dhe propozon masat për përparimin e punës dhe të veprimtarisë së Institutit si dhe popullarizimin e kësaj veprimtarie,
- Merr masa për zhvillimin e bashkëpunimit me institucione të ngjashme në vend dhe jashtë vendit,
- Kujdeset për aftësimin e kuadrove shkencore dhe profesionale,
- Ndërmerr masa për punën e suksesshme të Institutit,
- Kujdeset që puna materiale-financiare të zhvillohet në bazë të dispozitave të akteve normative të Kolegjit dhe të Institutit,
- Merr pjesë në mbledhjet (tubimet) e organeve udhëheqëse të Kolegjit dhe të Institutit,
- Lidh dhe nënshkruan kontrata në emër të Institutit në marrëveshje me Rektoren e Kolegjit.
- Përfaqëson Institutin para gjykatave, organeve apo personave të tretë
- Vendos për përdorimin dhe shpenzimin e mjeteve që ka Instituti gjer në shumën e caktuar sipas autorizimit të Rektorit.
- I raporton rregullisht organeve të Institutit lidhur me punën, realizimin e programeve dhe të planëve të punës së Institutit ose lidhur me problemet e ndryshme të Institutit,
- Del me propozim para organeve qeverisëse të Kolegjit dhe të Institutit,
- Tërheq vërejtjen lidhur me ligjshëminë e vendimeve,
- Merr masa lidhur me mbrojtjen e ligjshmërisë në punën e Institutit,
- Në kuadër të akteve normative të Institutit dhe të vendimeve të Kolegjit, jep urdhëresa me qëllim të realizimit me sukses të veprimtarisë së Institutit,
- Analizon problemet e Institutit dhe paraqet raport mbi gjendjen e konstatuar,
- Ushtron edhe të drejtat dhe detyra të tjera, të parapara me akte normative të Kolegjit dhe të Institutit.

#### Neni 12

Veprimtaria kërkimore-shkencore e Institutit është e organizuar nëpërmjet tre Njësive akademike të veçanta të përfaqësuara në Institut:

- Njësia e Institutit – Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
- Njësia e Institutit – Fakulteti i Stomatologjisë
- Njësia e Institutit – Fakulteti i Farmacisë

#### Neni 13

Punën e njësive të veçanta të Institutit e koordinon prodekani për shkencë i secilës njësi të veçantë.

Njësitë e Instituteve kanë nga 4 anëtarë, të emëruar nga Këshilli drejtues i Institutit.

## Këshillat e fushave shkencore

### Neni 14

Këshillat e fushave shkencore janë nga:

- shkencat Biokimike
- shkencat Fizioterapeutike
- shkencat Radiologjike
- shkencat Infermierore dhe mamisë
- shkencat e shëndetit publik dhe mjedisor
- shkencat e Menaxhmentit shëndetësor
- shkencat Stomatologjike
- shkencat Farmaceutike

Këshilli shkencor mund të përcaktojë edhe fusha të tjera shkencore, sipas nevojës.

### Neni 15

Këshillat e fushave shkencore bëjnë:

- vlerësimin profesional dhe shkencor të projekteve
- propozojnë shpërndarjen e mjeteve për projekte
- hartojnë propozim-projektet shkencore
- parashetrojnë kërkesa për organizimin e takimeve shkencore

### Neni 16

Këshillat e fushave shkencore i përbëjnë udhëheqësit e këshillave të fushave shkencore, mësimdhënësit e zgjedhur në tituj shkencorë-mësimor në lëndët e asaj fushe, si dhe anëtarët e tjerë të emëruar nga Këshilli shkencor. Këta mund të mos jenë të punësuar në institucionin shkencor.

### Neni 17

Veprimtarinë kërkimore-shkencore të Institutit e zhvillojnë punonjësit shkencorë me tituj shkencorë.

Me punë kërkimore-shkencore, krahas punëtorëve shkencorë, merren edhe hulumtuesit.

Përveç punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, punën kërkimore-shkencore në Institut e ushtrojnë edhe mësimdhënësit e zgjedhur në tituj shkencorë-mësimorë.

## Punëtorët shkencorë dhe hulumtuesit

### Neni 18

Për organizimin e punës në Institut, caktohen vendet e punës. Me vendin e punës nënkuptohet një sërë punësh, respektivisht detyrash të punës në kuadër të veprimtarisë punonjëse në Institut ku punon një ose më shumë punëtorë. Secili vend i punës ka emrin e vet. Emri i vendit të punës caktohet varësisht prej veprimtarisë, llojit të punës dhe detyrave të punës.

#### Neni 19

Secili vend i punës duhet të përfshijë punët dhe detyrat e punës që duhet të kryhen në atë vend pune.

#### Neni 20

Titujt shkencorë dhe hulumtues janë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari kërkimore-shkencore.

#### Neni 21

Këshilltari shkencor merr pjesë në përgatitjen e planeve dhe programeve të punës kërkimore – shkencore të Institutit. Studion problemet që kërkojnë njohuri të gjithanshme teorike dhe metodologjike nga disiplina shkencore e tij apo disiplinat e afërta.

Këshilltari shkencor punon lidhur me pjesët më të rëndësishme të programit, u jep këshilla e udhëzime bashkëpunëtorëve në Institut, përcjell rezultatet më të reja nga fusha apo specializimi i tij më i ngushtë; punon rreth projekteve, projekteve ideore, programeve, elaborateve, planeve nga fusha e Institutit, temave që shkruhen (përgatit trajtesa, studime, monografi nga seksioni i tij. Përgatit referate apo kumtesa për sesionet shkencore); studion materialet e mbledhura në Institut; dokumentat, periodikët, shtypin dhe literaturën e nevojshme në vend dhe në botën e jashtme; bën hulumtime në terren, individualisht apo në ekspedita në vend apo jashtë; punon rreth perfeksionimit shkencor në disiplinën përkatëse, përcjell literaturën shkencore dhe konsultohet me bashkëpunëtorët e rinj. Trajton probleme metodologjike që kanë rëndësi të përgjithshme për realizimin e detyrave kërkimore, trajton në mënyrë teorike problemet e ndryshme me rëndësi të veçantë.

Këshilltari shkencor udhëheq dhe koordinon punët e grupeve të ndryshme kërkimore – shkencore, vlerëson karakterin shkencor të projekteve të programeve të ndryshme, bën recensionet e punëve të kryera kërkimore në kuadër të Institutit. U ndihmon bashkëpunëtorëve të rinj në afatësimin e tyre në punën kërkimore-shkencore .

Këshilltari shkencor duhet të jetë doktor i shkencave, duhet të ketë arritur një shkallë të lartë të pjekurisë shkencore që dëshmohet përmes veprave të botuara me rëndësi të veçantë për Institutin me të cilën mirret.

#### Neni 22

Bashkëpunëtori i lartë shkencor merr pjesë në përgatitjen e programeve të punës kërkimore shkencore. Studion problemet që kërkojnë përgatitje të mirë teorike dhe metodologjike nga disiplinat e caktuara, merr pjesë në përgatitjen metodologjike për punë të ndryshme kërkimore shkencore, për realizimin e projekteve të caktuara kërkimore, studjon problemet e ndryshme nga lëmi shkencor i tij, bën hulumtime në mënyrë të pavarur lidhur me temën, përpunon pjesët e vështira dhe të rëndësishme të programit.

Bashkëpunëtori i lartë shkencor punon në mënyrë të pavarur rreth temave që shkruhen (si këshilltari shkencor) dhe rreth përgatitjes së projekteve ideore (si këshilltari shkencor); kryen recensionin e punimeve të ndryshme të bashkëpunëtorëve të tjerë, ndihmon bashkëpunëtorët më të rinj në aftësimin e tyre për punë shkencore.

Bashkëpunëtori i lartë shkencor duhet të jetë doktoruar nga lëmi përkatës, të ketë punime shkencore të botuara, të cilat janë të vlerësuara si kontribut shkencor.

#### Neni 23

Bashkëpunëtori shkencor studion problemet e ndryshme nga disiplina shkencore përkatëse. Punon në mënyrë të pavarur në hulumtimet shkencore lidhur me temën, në pjesë të veçantë të temës dhe në temë të veçantë, përgatit botime materialesh e botime nga fushëveprimtaria e vet, duke nxjerrë materiale nga fondi i Institutit, nga publikimet dhe arkivat, nga literatura profesionale dhe shkencore.

Bashkëpunëtori shkencor bën klasifikimin, seleksionimin, redaktimin dhe shkruan parathëniet lidhur me projekte, projekte ideore, programe, elaborate plane etj; punon rreth perfeksionimit në Institutin përkatëse, merr pjesë në hartimin e metodës dhe të instrumenteve përkatëse të hulumtimit në terren, individualisht apo në ekspedita u ndihmon bashkëpunëtorëve profesionalë dhe asistentëve në punën e tyre përkatëse.

Për këtë vend pune kandidati duhet të jetë doktor i shkencave dhe të ketë punime të vlerësuara shkencore.

#### Neni 24

Hulumtuesi i pavarur shkencor merret me punë profesionale të Institutit në të cilën punon; mbledh, klasifikon sistematizon materialet; punon rreth përgatitjes së botimeve, duke nxjerrë materiale nga fondi i Institutit, nga publikimet dhe nga arkivat; bën hulumtime në terren në vend dhe në botën e jashtme. U ndihmon asistentëve në kryerjen e detyrave të tyre, shkruan punime profesionale e shkencore nga veprimtaria e Institutit, konsulton literaturën shkencore e profesionale.

Kandidati hulumtues i pavarur shkencor duhet të ketë të përfunduar masterin, si dhe të ketë të publikuara punime profesionale-shkencore të vlerësuara pozitivisht.

#### Neni 25

Hulumtuesi shkencor merr pjesë në punën kërkimore-shkencore, mbledh, radhitë, përpunon, analizon, studion materialet e mbledhura në fondin e Institutit (dokumentet, periodikun, shtypin dhe literaturën e nevojshme, bën hulumtime në terren individualisht apo në vend dhe jashtë; punon rreth sistematizimit, klasifikimit, seleksionimit të lëndës së mbledhur; inkuadrohet në përgatitjen e materialeve apo dokumenteve; punon rreth prefeksionimit në lëminë përkatëse, konsultohet me bashkëpunëtorët shkencorë e profesionalë.

Kandidati duhet të ketë kryer fakultetin në nivelin bachelor, të ketë të regjistruar studimet e masterit, të ketë punime profesionale e shkencore të vlerësuara pozitivisht.

#### Neni 26

Vendi i punës: bashkëpunëtor i lartë shkencor, bashkëpunëtor shkencor, hulumtues i pavarur dhe hulumtues shkencor mund të plotësohen nga kuadri i rregullt mësimor i Kolegjit.

Rizgjedhjes i nënshtrohen: bashkëpunëtori i lartë shkencor dhe bashkëpunëtori shkencor, çdo pesë vjet, ndërkaq hulumtuesi i pavarur dhe hulumtuesi çdo tre vjet.

#### Neni 27

Instituti, ka personelin e vet tekniko-administrativ, si dhe mund të shfrytëzojë edhe administratën e përbashkët të Kolegjit.



Kushtet në të cilat Instituti shfrytëzon edhe administratën e Kolegjit, punonjësit e Institutit si dhe sistematizimi i vendeve të punës është e rregulluar me Rregulloren e punës së Institutit. Shërbimi tekniko-administrativ i Institutit përbëhet nga: Sekretari i Institutit, bibliotekisti i bibliotekës shkencore, arkivisti për punë shkencore, zyrtari për shërbimin informativ-shkencor dhe asistenti administrativ.

#### Neni 28

Biblioteka shkencore e Institutit organizohet ndaras nga biblioteka e Kolegjit, kjo ndarje mund të jetë e tërësishme ose vetëm për pjesë të veçanta të cilat nuk mund të inkorporohen në kuadër të bibliotekës së Kolegjit.

### FINANCIMI

#### Neni 29

Instituti veprimtarinë e vet kërkimore-shkencore e realizon nëpërmjet mjeteve financiare të siguruara nga:

- a) fondet vetanake të Institucionit
- b) mjetet që i realizon Instituti, me shërbimet komerciale shkencore e profesionale
- c) fondacionet dhe donacionet tjera alternative të ligjshme
- d) mjetet e buxhetit të Kosovës të destinuara për veprimtarinë kërkimore-shkencore, përkatësisht të projekteve për të cilat MASHT-i shpall konkurs
- e) grandet e jashtme për mbështetjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore
- f) nga burime të tjera të ligjshme.

#### Neni 30

Kolegji çdo vit kalendarik përcakton vlerën e mjeteve vetanake, si buxhet inicial i Institutit për përmbushjen e veprimtarisë së vet për atë vit kalendarik.

#### Neni 31

Çdo vit kalendarik Instituti e përpilon listën e shërbimeve komerciale shkencore e profesionale që i ofron institucioneve të tjera, të cilën e publikon në Informatorin e Institutit për vitin kalendarik gjegjës.

#### Neni 32

Mënyra e shfrytëzimit të mjeteve të siguruara nga neni 29, 1 pika a, b, c, d, e dhe f, përcaktohen në mënyrë të veçantë në Rregulloren e punës së Institutit.

## II. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

#### Neni 33

Me këtë Statut shfuqizohen Rregulloret paraprake që i rregullojnë këto çështje.

#### Neni 34

Për zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti kujdeset Rektori i Kolegjit. Statuti hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Rektorit.

Kryesuesi i Senatit të Alma Mater Europaea

Campus College Rezonanca

Acad.Prof.Dr. Arian R. Idrizaj, MD, Rektori i Kolegjit